



**Oda e Stomatologëve të Kosovës**  
**Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo**

**KËSHILLI DREJTUES I ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (OSK)**, në mbështetje të nenit 21, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.2 ; nenit 27, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.2 të Stautit të Odës së Stomatologëve të Kosovës, në takimin e mbajtur me 11.05.2021 dhe vendimit nr 1875 të datës 11/05/2021 mbi ndrrimin e lokacionit të zyreve të OSK, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. Hapësirat e reja për zyre të OSK-së duhet të përmbajnë të paktën këto kritere minimale :
1. Sipërfaqja e ambienteve për zyra të variojë nga 55 m<sup>2</sup> - 75 m<sup>2</sup>;
  2. Të jenë së paku tri ambiente të ndara në të njëjtin objekt dhe të jenë funksionale;
  3. Të jetë në gjendje të rregullt pa pasur nevojë për ndërhyrje të tjera për renovim;
  4. Energjia elektrike, uji dhe shërbimet tjera të jenë të instaluar në objekt/zyre, lifti instaluar nëse hapësira është në katin e dytë apo më lartë;
  5. Ambienti i zyrave duhet të ketë ndriçim natyral, të ketë tualet të kompletuar me hidrosanitare;
  6. Parking i hapur;
  7. E lidhur me ngrohtoren e qytetit Termokos;
  8. Lokacioni i objektit të jetë në Prishtinë (Qendër, Lagjja Ulpianë, Dardani);
  9. Kohëzgjatja e qëras do të jetë 3 vite, me mundësi vazhdimi;
  10. Çmimi jo më i lartë se 450 Euro;
  11. Paguesa e qirasë do të bëhet çdo muaj në euro (brenda një date që do të përcaktohet në marrëveshje mes palëve.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Kryesuesi i Këshillit Drejtues  
Prof.Dr. Blerim Kamberi

